



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

**Vendim**

Nr. 37 Date 22/09/ 2017

**Për**

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Gjoni” nga subjekti “REDEN” shpk, Përroi i Lusës degë e lumit Mat, në Bashkinë Burrel, Qarku Dibër.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar), me propozim të A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat**,

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**Reden**” shpk me Administrator Z.Sali Kurti, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike” sipas studimit të paraqitur nga subjekti “**Reden**” shpk, me këto të dhëna:

**HEC “Gjoni”**

Subjektit juridik/fizik “**REDEN**” shpk:

**Përroi i Lusës degë e lumit Mat** me vendodhje në Bashkinë Burrel, Qarku Dibër.

- Prurja mesatare 2.31 m3/sek
- Prurja llogaritese 3.3m<sup>3</sup>/sek,
- Prurja ekologjike 0.31m<sup>3</sup>/sek
- Kuota e Vepra e marrjes : **Z- 262m.n.d**
- Kuota e godines se HEC-i: **Z- 173 m.n.d**                      X – 41 89 95.39                      Y- 46 05 023.35
- Fuqia e instaluar : 1.941kw /ore pune ne vit 3815
- Kapaciteti prodhues mesatar: 7 41Gwh

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT**

Ast **NIKOLLA**

**KRYETARI I K.B.U. MAT**

**Eduard NDRECA**

